



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 21.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.08.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Kema Company" për aktivitetin: "Ndertimi i rruges nga Flotacioni në Lagjen Vakovc" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1262-511 nxjerr:

### V E N D I M

**Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Kema Company" e datës 19.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i rruges nga Flotacioni në Lagjen Vakovc" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1262-511 kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 15.08.2020*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Vertetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 15.08.2020;**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Kema Company" ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i rruges nga Flotacioni në Lagjen Vakovc" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1262-511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 21.08.2020 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimi juaj se tenderi juaj është refuzuar pa të drejte si tender me çmim abnormalisht të ulët është i pa bazuar për faktin se çmimet e dhena dhe sqarimet tuaja janë vlerësuar në mënyrë korrekte nga komisioni profesional dhe për çmimet e ofruara në pozicionet që ju i përmendni në kërkesë nuk mund të gjindet asnjë arsye. Ajo që ju thonë se jeni prodhues apo keni marrëveshje furnizimi nuk mund të merren si argumente, pasi që edhe ju e dini se çdo prodhim ka një kosto reale të tregut dhe poashtu edhe çdo furnizim, prandaj deklarimet dhe marrëveshjet fikitive sa për pjesëmarrje në tender nuk mund të jenë arsye për çmimet e

dhena nga ana juaj.Lidhur me parakushtet per rritjen e sigurise se ekzekutimit ju sqaroj se kjo mund te aplikohet,por vetem ne rastet kur Autoriteti Kontrakttues beson se e njejta i mbulon demet eventuale te shkeljes se kontrates e qe ne rastin tuaj eshte konsideruar se rritja e sigurise nuk e garanton te njejten.

Bazuar ne sqarimet paraprake u vendos si ne Dispozitiv te Vendimit.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit